



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:177699
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05747191

P nr.927/20

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PEJË – DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Ilda Cucović Sahatçiu, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Gylaj Nepola, në çështjen penale kundër të pandehurit D.Z nga Peja, për shkak të veprës penale „Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së dhe të pandehurit F.H nga Peja për shkak të veprës penale „Sulmi” nga neni 184 par.1 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore – Departamenti i Përgjithshëm në Peje, PP/II..nr.1858/2020 dt.11.12.2020, pas mbajtjes se seancës të shqyrtimit gjyqësor të hapur për publikun, me dt. 22.04.2024 në praninë e Prokurores së Shtetit Lumturije Hoxha dhe të pandehurve D. Z dhe F. H me dt. 23.04.2024 merr dhe publikisht shpall, ndërsa me datë 21.05.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1.D.Z, nga i ati F dhe nëna K e vajzërisë M , i lindur me datë në Pejë, me vendbanim në Rr., A.Sh” nr..., ka të kryer shkollën e,,, i gjendjes së mesme ekonomike, identifikohet sipas letërnjoftimit me nr. personal të lëshuar nga MPB të R. Kosovës, me nr. tel....., shqiptar, shtetas i R. Kosovës, mbrohet në liri.

2. F. H, nga i ati Bardh. dhe nëna Zejnije e vajzërisë Osmanaj, i lindur me 15.01.2002 në Pejë, me vendbanim në Rr., Avni Rrustemi”nr.12, ka të kryer shkollën e mesme, student, beqar, i gjendjes së mesme ekonomike, identifikohet sipas L. Njoftimit me nr. personal 1171234847, lëshuar nga MPB të R. Kosovës, me nr. telefonit 043/783-454, shqiptar, shtetas i R. Kosovës, gjendet në liri.

JANË FAJTOR

Për shkak se :

I pandehuri D.Z,

- I.** Me me dt..... rreth orës minuta në rr., Z. P në Pejë, pikërisht te pompa e derivateve ,,’’ me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet të dëmtuarit F.H, në atë mënyrë që pas një konflikti verbal, i pandehuri D e ka grushtuar disa herë në pjesë të ndryshme të trupit të dëmtuarin, e si pasojë e lëndimeve sipas ekspertizës mjeko-ligjore të punuar për rastin, i dëmtuari ka pësuar, lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndet,
- me çka ka kryer vepër penale ,, Lëndim i lehtë trupor’’ nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së.

I pandehuri F. H,

- II.** Me dt..... rreth orës minuta në rr., Z. P’’ në Pejë, pikërisht te pompa e derivateve ,,’’ pas një konflikti verbal me të dëmtuarin D. Z ,me dashje ka përdor forcën ndaj të dëmtuarit, në atë mënyrë që i pandehuri e sulmon dhe e godet me grusht-a disa herë të dëmtuarin në pjesë të ndryshme të trupit.me dashje i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet të dëmtuarit F.H a, në atë mënyrë që pas një konflikti verbal, i pandehuri D e ka grushtuar disa herë me grusht në pjesë të ndryshme të trupit,
- me çka ka kryer vepër penale ,, Sulmi’’ nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Andaj, konform nenit 7, 38, 39, 40, 43, 69, 70, nenit 185 par.1 pika 1.4 të KPRK-së, nenit 184 par.1 të KPRK-së dhe nenit 364, 365, 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, 452, 460, 462 par.2 të KPRK-së, gjykata të pandehurve, secilit veç e veç iu shqipton :

DËNIM ME GJOBË

Ashtu që të pandehurve iu përcakton :

- I.** Të pandehurit **D. Z** dënim me gjobë në lartësi prej **800 (tetëqind) euro**, të cilin dënim i pandehuri obligohet të paguaj brenda afatit prej 60 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata konform nenit 43 paragrafi 3 i KPRK-së mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ku 20 € (njëzet euro) gjobë llogaritet barabartë me 1 (një) ditë burgim.

- II.** Të pandehurit **F. H** dënim me gjobë në lartësi prej **500 (pesëqind) euro**, të cilin dënim i pandehuri obligohet të paguaj brenda afatit prej 60 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse i pandehuri nuk dëshiron ose nuk mund të paguajë gjobën, gjykata konform nenit 43 paragrafi 3 i KPRK-së mund të zëvendësojë dënimin me gjobë me dënim me burgim, ku 20 € (njëzet euro) gjobë llogaritet barabartë me 1 (një) ditë burgim.
- a) Të pandehurit obligohen që secili veç e veç, gjykatës t'i paguajnë shpenzimet e procedurës dhe atë paushallin gjyqësor dhe atë secili nga **20 € (njëzetë euro)**, në afat prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh**, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.
 - b) Të pandehurit obligohen që secili veç e veç ta paguajnë taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, dhe atë secili nga **20 € (njëzetë euro)**, në afat prej **15 (pesëmbëdhjetë) ditësh** pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.
 - c) I pandehurit D. Z ka heq dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.
 - d) I pandehuri F.H për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest juridiko civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti i Përgjithshëm, ka ngrit aktakuzë nën shenjë PP/II. nr.1858/2020 me datë dt.11.12.2020, kundër të kundër të pandehurit D. Z për shkak të veprës penale „ Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 par.1 nën par.1.4 të KPRK-së dhe kundër të pandehurit F.H për shkak të veprës penale „ Sulmi” nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Konform nenit 240 të KPRK-së, gjykata mbajti shqyrtimin fillestar me datë 12.10.2023,ku të pranishëm ishin Prokurori Shtetit Ermal Demhasaj dhe të pandehurit D.Z dhe F. H.

Gjykata konform dispozitave të nenit 241 par.1 të KPRK-së, i ka udhëzuar të pandehurit në të drejtat e tyre.

Pas leximit të aktakuzës, gjykata është bindur se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, iu ka dhënë mundësinë që të deklarohen për pranimin ose mospranimin e fajësisë. duke i udhëzuar për natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë.

I pandehuri D.Z deklaroi se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzë, ndërsa i pandehuri F.H është deklaruar i pafajshmen për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës.

Gjykata pas deklarimit të palëve e konform nenit 242 par 2 dhe par.6 të KPPRK-së, u pajtuan me pranimin e fajësisë nga i pandehuri D.Z, e ka miratuar pranimin e fajësisë, ndërsa për të pandehurin F. H ka vazhduar procedura penale.

Prokurori i shtetit lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit për të pandehurin D Z i propozoi gjykatës që në kontekst të rrethanave lehtësuese të merr parasysh pranimin e fajësisë, ndërsa si rrethanë rënduese moshën e re të viktimës si dhe dënimet eventuale të mëparshme.

I pandehuri F.H deklaroi se do të paraqet kërkesë pasurore juridike.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur seancat e shqyrtimit gjyqësor në raport e të pandehurin F. H dhe atë me datë 22.01.2024 me datë 04.03.2024. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 22.04.2024 i pandehuri F. H ka deklaruar se e pranon fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë.

Gjykata pasi është bindur se pranimi i fajësisë nga i njëjti është bërë konform dispozitave të nenit 322 lidhur me nenin 242 par. 2, nën par. 2.1, 2.3, 2.4 të KPPRK-së dhe ka mbështetje në provat nga shkresat e lëndës siç janë: Raporti fillestar i incidentit me nr. te rastit 2020-DA-1572 i dt.15.10.2020,raporti i policit Hysen Krasniqi i dt.16.10.2020,deklarata e të dëmtuarit e dhënë në polici me dt.15 dhe 16 .10.2020, deklarata e dëshmitarit K.K dhënë në polici me datë 15.10.2020,deklarata e dëshmitarit E.L e dhënë në polici me dt.15.10.2020,deklatrata e dëshmitarit E.D e dhënë në polici me dt.16.10.2020, deklarata e të pandehurit D.Z e dhënë në polici me dt.16.10.2020,deklarata e të pandehurit F.H e dhen në polici me dt.22.10.2020,raportet mjekësore për të lënduarin të lëshuara nga Spitali regjional në Pejë, akt ekspertimi mjeko ligjor i punuar nga eksperti mjeko ligjor Vesa Kotori MD FMD me dt.11.11.2020,fotografi nga vendi i ngjarjes dhe shkresat tjera të lëndës, e ka miratuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga i pandehuri pasi që ky pranim ka mbështetje edhe në shkresat e lëndës dhe i propozoi gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit të merret parasysh si rrethanë lehtësuese pranimi i fajësisë ndërsa rrethanat rënduese ia le në vlerësim gjykatës.

I pandehuri D.Z deklaroi se me të pandehurin F tani ka raporte korrekte duke shtuar se heq dorë nga realizimi i kërkesës pasurore juridike.

I pandehuri F H i propozoi gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin të merret parasysh fakti se e ka pranuar fajësinë, i ka përmirësuar raportet me të pandehurin- D dhe shtoi

se është pënduar për veprimet e ndërmarra dhe i njëjti i premtoi gjykatës se nuk do të kryej më veprë penale.

Nga faktet e ofruara si dhe nga pranimi e fajësisë nga ana e të pandehurve, gjykata vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të aktgjyimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, padyshim vërtetohet se në veprimet e të pandehurve D.Z qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale „Lëndim i lehtë trupor” nga neni 185 lidhur me par.1 pika 1.4 të KPRK-së ndërsa për të pandehurin F.H elementet e veprës penale „ Sulmi” nga neni 184 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë gjykata ka gjetur se tek të pandehurit ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që të pandehurit kanë qenë i vetëdijshëm për veprat e kryera dhe e kanë dëshiruar kryerjen e tyre.

Gjykata gjatë procedurës penale nuk gjeti rrethana të cilat do të zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurve, kështu që të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Gjykata, për vendimin mbi dënim ka vendosur pasi që i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-se për secilin të pandehur. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin D, ka vlerësuar faktin se i njëjti qysh në fazën fillestare të procedurës e ka pranuar fajësinë për veprën penale që i vihet, nuk është dënuar asnjëherë më parë me aktgjykim dënues të plotfuqishëm, raportin korrekt me të pandehurin F ndërsa rrethanë rënduese gjykata në rastin konkret nuk gjeti.

Me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit F.H, gjykata si rrethanë lehtësuese morri parasysh pranimin e fajësisë, keqardhjen e shfaqur, raportin korrekt me të pandehurin D, premtimin se nuk do të bie ndesh me ligjin, ndërsa rrethana rënduese për të njëjtin gjykata nuk gjeti.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi i shqiptuar të pandehurit D dhe F , duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, për secilin është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale së të pandehurve. Gjykata, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurve nga kryerja respektivisht përsëritja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale në emër të paushallit gjyqësor është marrë konform nenit 449 par.1 dhe 2 nën par. 2.6, nenin 450, 452 paragrafi 1 të KPP-së, si dhe për shpenzimet për programin për kompensimin e viktimave të krimit duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 3, nën

paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimin, në të cilat të pandehurit obligohen t'i paguajnë brenda afatit e nën kërcënim të përmbartimit me dhunë.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 364 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, gjykata përpiqet këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
Divizioni Penal
P.nr.927/2024, me datë 21.05.2024

Bashkëpunëtore profesionale

Gylaj Nepola

Gjyqtare e vetme gjykuese

Ilda Cucović Sahatçiu

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.